



Niveli i pushtetit më i afërt për qytetatin është Komuna. Në Belgjik, janë 589. Në 262 qytete dhe komunat Wallonne ndahem në 5 Krahina: Brabant Wallon, Hainaut, Liège, Luxembourg dhe Namur.

Kompetencat komunale i përkasin të gjithave nevojave të përbashkëta të banesave: mirëmbajtja e rregullit publik, administrimi i gjendjes civile dhe mbajtja e regjistrave të popullatës, martesat, pastërtia publike, CPAS-it, që administron ndihmën sociale, punimet publike, banesat, arsimit komunal.

Eshtë Administrata komunale ku adresohem për të gjitha dokumentat e nevojshme për procedurën time. Në veçanti; është Administrata komunale që deklaron **banesën time**. Një polic dërgohet tek shtëpia ime për të vërtëuar nëse banoj të vërtetë aty; sipas këtij raporti, Administrata më lëshon një vërtetim për banesën. Ky dokument do të më kërkohet për gjëra të mëtejshme.

Shërbimi i të Huajve administron pyetjet specifike në çështje me qëndrimin. Ai nuk merr vendim: ai aplikon udhëzimet e Zyrës të Huajve.

Kryesisht në Administratën komunale zgjas ose përsëris kartën time të qëndrimit, kur deklaroj një ndryshim adrese ose një ndryshim në përbërjen familjare.

Kur jam banues në një komunë, une mund të përfitoj nga shërbimet që ajo i afrohet popullatës të saj.

Sa të arrij, intersohem pra për këto shërbime dhe për antenat administrative ku mund të shkoj për të rregulluar situatën time.



C.P.A.S. = Qendra Publike e Veprimtarive Sociale



C.P.A.S.

CPAS-i është shërbimi komunal i solidaritetit e financiar nga taksat e qytetarëve që punojnë. Ai organizon ndihmat për personat që paraqiten në territorin e Komunës që kanë vështirësi materiale, financiare, sociale ose psiko-sociale. Në Belgjik, çdo person ka të drejtën e ndihmës sociale kjo këtu ka për qëllim të lejojë secilit të këtë një jetë të përshtatshme në dinjitetin njerëzor. Për ta marrë, duhet megjithatë ti përgjigjeni një seri kriteresh dhe të jepni dokumentat që ju kërkojnë.



Kur unë paraqitem në CPAS, një punëtor social është i caktuar për të shqyrtuar situatën time dhe hap një dosje. Të gjitha kërkesat i nënshtrohen vendimit të një këshilli të përbërë nga përfaqësuesit e zgjedhur nga popullata. punëtori social i paraqet kërkesat e mia dhe me komunikon pastaj vendimet.

Si të gjitha kërkesat administrative, kjo këtu iu përgjigjet rregullave të ndërlikuara dhe të rrepta. Etapa e parë qëndron në verifikimin cili CPAS-i është kompetent: të shumtën e kohës, është CPAS-i vendit time të banesës, por kriteret e tjera mund të mirren parasysh.

Në fillim punëtori social është një person i besueshëm me përvojë i cili më dëgjon dhe përpiqet ti përgjigjet kërkesave të mia. Është e rëndësishme ti kuptoni mirë që nuk është ai që merr vendimet. Ai shërben si ndërmjetës midis përfituesve dhe instancave që vendosin..





Kujdes, çdo ndihmë e dhënë është e kushtëzuar në vendin tim të banëses dhe vlefshmërinë e titullit tim të qendrimit. Unë jam pra shumë i vëmendshëm për të parashikuar përsëritjen e dokumentave të mija dhe lajmëroj përpara punëtorin(en) sociale (e) për çdo ndryshim banese me qëllim që të siguroj transferimin e dosjes time në një tjetër CPAS. çdo ndryshim në situatën time ka pasoja mbi kushtet e ndihmës të dhënë.

Nga ana tjetër, **dhënia e ndihmës është të shumtën e kohës e kushtëzuar nga një seri detyrimesh** (për tu formuar, për të gjetur një punë,..). Unë jam pra shumë i vëmendshëm për plotësimin e këtyre detyrimeve dhe për të lajmëruar punëtorin (en) social (e). Ndihma e CPAS-it nuk jepet vetëm në qoftëse nuk egziston asnjë mundësi tjetër për plotësimin e nevojave tuaja.



Punëtori (ja) social (e) bën me mua pikën mbi situatën time dhe redakton një raport me shkrim.

Kërkesat mund të jenë:

- Kërkesë e ndihmës sociale për plotësimin e nevojave të mija.
- Kërkesë financiare për transportet.
- Kërkesë financiare për të paguar qiranë e parë dhe garoncinë e qiradhënies.
- Kërkesë për një shpërblim të instalimit.
- Kërkesë financiare për një faturë mjekësore ose një ndjekje mjekësore.
- kërkesë të marrjes në ngarkim të shpenzimeve shkollore.
- ...

Shembull

Unë gjej një studjo në të cilën unë mund të hyj me 15 Janar. Qiraja ime është 450€ euro në të gjitha sëbashku. Pranari im më kërkon 2 muaj garonci për qeradhënien. Unë duhet përsëri të blej disa gjëra përpara se të hyj (në banëse), një shumë prej 200 euro. Gjithashtu për një abonim autobusi për të vajtur në kurs : shuma e abonimit është 20 euro/në muaj.

Unë bëj tek punëtori (ja) social (e) një kërkesë të përgjithshme të ndihmës sociale. Unë kërkoj gjithashtu një paradhënie për qiranë time të parë dhe për garoncinë e qiradhënies (që do t'ju a kthej sipas një plani që më është propozuar). Në fund unë kërkoj që CPAS-i të më japë një paradhënie të hollash të nevojshme për t'ia dalur deri me 31 Janar dhe një shumë për të paguar abonimin tim.



Një paradhënie është një hua të hollash. Ajo nënkupton (kthimin e të hollave) Në të kundërtën e ndihmës që nuk kthehen të hollat që, siç e thotë dhe emri, të hollat nuk kthehen(dmth nuk keni për të paguar).

Punëtori (ja) social (e) paraqet anketën e tij sociale Këshillit dhe më komunikon vendimet CPAS-i më dërgon konfirminin me shkrim me letër rekomande. Në qoftëse nuk jam dokort me vendimin e Këshillit, unë mundem të bëj një ankesë brenda 30 ditëve në këtë rast, unë bëj thirrje një avokati ose një shërbimi juridik, që bën ankesat falas pranë Gjykatës të Punës.



Këshilli do të japë ndihmë duke u bazuar në një vlerësim të anketës sociale. Nëse unë jetoj me dikë ose nëse dikush mund të sigurojë qoftë edhe një pjesë të nevojave të mia, ndihma mund të jetë e pjesshme ose të refuzohet.



Shërbimet << Të drejtat e të rinjëve >>

Ato informojnë të rinjtë mbi të drejtat e tyre dhe i ndihmojnë për ti respektuar në çështje me shkollën, punën, ndihmën sociale, ndihmë rinisë , legjislacionin për të huajt. Ato janë caktuar për të luftuar kundër përjashtimit social dhe të favorizojnë hyrjen në pavarësi të rinjve dhe të familjeve. Shërbimet e tyre janë falas dhe kujdestaritë janë të organizuara gjatë javës.



www.sdj.be

Qendrat e planifikimit familjar dhe Qendrat e ndihmës dhe të informacionit seksual, bashkëshortor dhe familjar

Ato presin dhe informojnë në çështje me shtatzaninë, kontrceptimin dhe të sëmundjeve seksuale transmetuese. Ato propozojnë aktivitete në grup dhe konsulta psikologjike, juridike, mjekësore dhe sociale.



www.loveattitude.be/centres-de-planning

Zyra e lindjeve dhe e fëmijërisë

Ajo siguron falas ndjekjen e shtatzanisë dhe të zhvillimit të fëmijës (gjendjen e shëndetit, vaksinat, të ushqyerit, të folurit). Ato sigurojnë gjithashtu shërbimet e pritjes të fëmijës: qëndrim-ruajtjeje, shtëpia të hapura, çerdhe, shërbimet e rojtareve profesionale (kujdestare) Këto shërbime janë me pagesë.



www.one.be

Shërbimet për personat e sëmurë

Kur unë jam i pa aftë të eci, shërbimet e vaktheve që shpërndahen në shtëpi, janë të organizuara nga CPAS-i, huaja e materialit (baterica, karrocë,...) është e organizuar nga Kruqi i Kuq ose nga Administrata e Sigurimeve Mjekësore (Mutuelle).